

VENDIM
Nr. 327, datë 31.5.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FUNKSIONET DREJTUESE DHE
PËRCAKTIMIN E KLASËS SË PAGËS SË DIPLOMATËVE TË KARRIERËS QË
PUNOJNË NË MINISTRINË PËRGJEGJËSE PËR PUNËT E JASHTME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të shkronjës “h”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të pikës 3, të nenit 39, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen diplomatët e karrierës që punojnë në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme.

2. Paga e diplomatit të karrierës, i cili punon në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme, caktohet në bazë të gradës diplomatike personale dhe funksionit që ai kryen, sipas përcaktimit në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore për secilën klasë të përcaktuar në lidhjen nr. 1, si dhe vlerat për secilin element janë të njëjta me ato të miratuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në institucionet e administratës shtetërore.

4. Në funksionet drejtuese, të përcaktuara në strukturën e ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, emërohen:

a) “Përgjegjës sektori”, nëpunësit e shërbimit të jashtëm, me gradë diplomatike jo më të ulët se “Sekretar i parë” apo të barasvlershme me të;

b) “Drejtor drejtorie”, nëpunësit e shërbimit të jashtëm, me gradë diplomatike jo më të ulët se “Këshilltar” apo të barasvlershme me të;

c) “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme”, nëpunësit e shërbimit të jashtëm, me gradë diplomatike jo më të ulët se “Ministër Këshilltar” apo të barasvlershme me të.

5. Në rastet kur në funksione drejtuese emërohen nëpunës të shërbimit të jashtëm, me gradë më të lartë se minimumi i përcaktuar për funksionin përkatës, sipas pikës 4, të këtij vendimi, ata paguhën sipas gradës diplomatike/konsullore, që kanë.

6. Vendimi nr. 881, datë 20.12.2006, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për funksionet drejtuese dhe përcaktimin e kategorisë së pagës së nëpunësve me grada diplomatike në Ministrinë e Punëve të Jashtme”, i ndryshuar, shfuqizohet.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data 1 prill 2023 dhe për vitin 2023 përballohen nga fondet e kontingjencës, të miratuara për këtë vit.

8. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja nr. 1

Nr.	Grada diplomatike	Pozicioni	Klasa e pagës
1	Ambasador.	Sekretar i Përgjithshëm	I-2
2	Ministër Fuqiplotë. Ministër Këshilltar.	Drejtor i Përgjithshëm	I-4

	Konsull i Përgjithshëm.		
3	Këshilltar.	Drejtor drejtorie.	II-1
4	Sekretar i Parë. Konsull.	Përgjegjës sektori.	III-1
5	Sekretar i Dytë. Zëvendëskonsull.	Specialist.	IV-1
6	Sekretar i Tretë. Agjent Konsullor.	Specialist.	IV-2
7	Atashe.	Specialist.	IV-3